



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

th e r r e t

mbledhjen e **dhjetë** të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më **28.12.2022** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. "UÇK", nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për hapjen e kodit buxhetor, nr. 01-400/01-177472/22, dt. 26.07.2022;
3. Propozimvendimi për miratimin e projektregullores për orarin e punës dhe mbrojtjen nga ndotja akustike në sektorin e gastronomisë;
4. Propozimvendimi për miratimin e projektregullores për transparencë;
5. Propozimvendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arif Dermishit;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shukrije Bajgorës, Muhamed Sadikut, Adnan Sadikut dhe "Vëllezërit Asllani" SHPK;
8. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e objektit të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë;
9. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2023;
10. Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Trafiku Urban" SHA, Prishtinë;

11. Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore;
12. Informatë nga Drejtoria e Kulturës;
13. Pyetje dhe përgjigje;
14. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-269379/22, më 14.12.2022

